



# BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Mars 2023

## NGRITJA E KAPACITETEVE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE - NË FOKUS TË VEPRIMTARISË SË AKCESK



AKCESK, në cilësinë e Autoritetit qendror dhe të vetëm të sigurisë kibernetike në Shqipëri, si dhe në kuadër të planit të ri strategjik për forcimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, vijon trajnimet e dedikuara për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafeve përgjegjës të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

Në datat 27 Shkurt -3 Mars, përfaqësues të niveleve drejtues të AKCESK dhe të disa prej infrastrukturave kritike të informacionit zhvilluan me sukses trajnimin CISSP.

## TAIEX WORKSHOP ON CYBER SECURITY INCIDENTS



U zhvilluanë Tiranë, seminari mbi “Incidentet e Sigurisë Kibernetike” me mbështetjen e instrumentit TAIEX të Komisionit Evropian.

Qëllimi i seminarit është fokusimi në forcimin e kapaciteteve për t’iu përgjigjur incidenteve kibernetike në infrastrukturat kritike të informacionit.

Seminari përfshin optimizimin dhe praktikimin e skenarëve të përshkallëzimit të incidenteve kibernetike, vendimmarrjen në rastet e krizës kibernetike dhe sigurimin e përdorimit efikas të mjeteve dhe burimeve të disponueshme të ekipeve të CSIRT.



## SIGURIA KIBERNETIKE PRIORITET KRYESOR NE AGJENDEN E KOMBEVE TE BASHKUARA




Shqipëria, nëpërmjet Misionit të Përhershëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), ishte i vetmi vend i Rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili pati një rol aktiv, në përmbushje të angazhimeve në terma të ndërtimit të dialogut të vazhdueshëm dhe konstruktiv institucional, për çështjet e sigurisë kibernetike nën kujdesin e OKB-së, në linjë të plotë me prioritetin e Qeverisë Shqiptare në këtë fushë.

Delegacioni i Shqipërisë u përfaqësua nga znj. Naureda Breshanaj, e mbështetur nga përfaqësuesja e AKCESK, Znj. Klorenta Pashaj, pjesëmarrja e të cilave u mbështet nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja e Hapësirës Kibernetike dhe Politikave Digjitale (CDP), në kuadër të fuqizimit të grave në çështjet e sigurisë kibernetike në OEWG.

Në deklaratën e saj, Shqipëria theksoi hapat konkretë të ndërmarrë në përgjigje të kërcënimeve kibernetike potenciale dhe normave të sjelljes së përgjegjshme të shteteve në hapësirën kibernetike.

Diskutimet mbi masat e ndërtimit të besimit dhe rritjes së kapaciteteve të vendeve anëtare të OKB, në kuadër të OEWG, vijuan deri në datën 10 Mars.



KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039

Email: [info@cesk.gov.al](mailto:info@cesk.gov.al) Web: [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)